



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK



VENDIM

Nr. 47, datë 29.05.2020

PËR  
PËR MIRATIMIN E MASËS SË GRANTIT TË RIKONSTRUKSIONIT OSE  
RIPARIMIT PËR NIVELIN E DËMIT DS1, DS2 DHE DS3, PËR BANESAT  
E DËMTUARA NGA TËRMETI I DATËS 26.11.2019 NË QYTETIN E DURRËSIT

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Akti Normativ nr.9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimet njerëzore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 6.1.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, i ndryshuar dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve në Bashkinë Durrës, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK  
V E N D O S I :

1. Miratimin e masës së grantit të rikonstruksionit ose riparimit për nivelin e dëmit DS1, DS2 dhe DS3, për banesat e dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 në qytetin e Durrësit si më poshtë vijon:



- a. Për nivelin e dëmit DS1, masa e vlerës së rikonstruksionit ose riparimit të jetë 100.000 (njëqind mijë) lekë.
  - b. Për nivelin e dëmit DS2, masa e vlerës së rikonstruksionit ose riparimit të jetë 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë.
  - c. Për nivelin e dëmit DS3, masa e vlerës së rikonstruksionit ose riparimit të jetë 500.000 (pesëqind mijë) lekë.
2. Shfuqizimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.36, datë 12.05.2020 “Për miratimin e përlllogaritjes së vlerës mesatare të masës së grantit të rikonstruksionit ose riparimit për nivelin e dëmit DS1, DS2, DS3 për banesat e dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 në qytetin e Durrësit”.
  3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi administrata e Bashkisë Durrës.
  4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

## KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



**U shpall sot me datë 29.05.2020**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS


Nr. 488/prot.  
7

Durrës, më 03.06.2020

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK ✓

DURRËS



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.47 datë 29.05.2020 “Për për miratimin e masës së grantit të rikonstruksionit ose riparimit për nivelin e dëmit DS1, DS2 dhe DS3, për banesat e dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 në qytetin e Durrësit”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

